

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 13/02/2025		
Njësi.org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016	/01-001	0291/25
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosova
 Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

REPUBLIKA E KOSOVËS
 BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
 Islamic Community of Kosova
 KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË PODUJEVË

KOMUNA E PODUJEVËS

Të cilën e përfaqëson z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës

Dhe

KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË PODUJEVË

Të cilën e përfaqëson z.Mensur Hoti, Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame – KBI në Podujevë

Në kuadër të autorizimeve sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës, nr.prot.01-400/01-0078829/24 të datës 11 dhjetor 2024, lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT

I

Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përhershëm, përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bën subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit, ndërsa Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kryen shërbimet e varrimit sipas rregullave dhe traditave përkatëse.

II

Shërbimet e varrimit përfshijnë: transportin e kufomës, fletë lajmërimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefinin.

III

Këshilli i Bashkësisë Islame, kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimore, i bashkëngjitë konstatimin e vdekjes nga mjeku dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar - nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja e letërnjoftimit apo nr.personal).

Faturat e shërbimeve i përgatit në baza mujore me dëshmi përkatëse për çdo rast të varrimit veç e veç.

IV

Komuna e Podujevës, faturat e dërguara nga Këshilli i Bashkësisë Islame i paguan në periudhën prej 01 deri më 15 në çdo muaj për muajin paraprak.

Faturat i dërgohen Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

V

Subvencionimi i shërbimeve të varrimit, sipas kësaj Marrëveshje, në asnjë mënyrë nuk ndërlikohet me pagesën e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame.

VI

Pastrimi i kufomave bëhet në vendin për pastrimin e kufomave në Bashkësinë Islame apo sipas dëshirës së familjarëve pastrimi i kufomës mund të bëhet edhe në shtëpinë e të vdekurit.

VII

Dëshminë e mjekut për konstatimin e vdekjes e siguron familja e të vdekurit.

VIII

Këshilli i Bashkësisë Islame - Dega në Podujevë, në kërkesë të familjarëve qoftë përmes telefonit apo formave tjera, bën transportin e kufomës (*bartja e kufomës nga shtëpia deri në Xhami dhe përcjellja deri te varrezat; bartja nga Aeroporti në familje kur kufomat sjellën nga jashtë vendit; bartja e kufomës nga QKUK deri te familja në rastet kur ndërrojnë jetë në QKUK apo në ndonjë spital tjetër, si dhe transport shtesë varësisht kërkesës së qytetarit/familjarit*), i cili deri në momentin e vdekjes ka qenë me vendbanim të përhershëm në Komunën e Podujevës.

IX

Marrëveshja lidhet për periudhën deri më 31 dhjetor 2026.

X


Marrëveshja zbatohet nga data 01 janar 2025.

XI

Kësaj marrëveshje i bashkëngjitet Çmimorja përkatëse e ofrimit të shërbimeve të varrimit si pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-400/01-0078829/24 i datës 11.12.2024.

Podujevë,
Shkurt 2025

Komuna e Podujevës
Shpejtim Bulliqi



Këshilli i Bashkësisë Islame - Podujevë
Mensur Hoti





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, Rregullores Komunale për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, neneve 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, sipas kërkesës nr.208/24 të datës 22.11.2024 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, të proceduar në Komunën e Podujevës përmes Kërkesës nr.prot.02-120/010-0075543/24 datë 22.11.2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2024, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevës sipas të cilës Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përhershëm përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për periudhën deri më 31 dhjetor 2026.

Neni 2

1. Për çdo të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja, bëhet subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Bashkësia Islame përkatësisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, që përfshijnë: transportin e kufomës, fletëlajmrimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefinin.

2. Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimore, i bashkëngjit edhe konstatimin e vdekjes nga mjeku, dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar-nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja ose numri i letërnjoftimit).

Neni 3

Autorizohet Kryetari i Komunës, të lidhë Marrëveshje Mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, në cilësinë e subjektit të vetëm për ofrimin e shërbimeve sipas këtij vendimi, përmes së cilës definohej më në detaje obligimet dhe përgjegjësitë.

Neni 4

Subvencionimi bëhet nga mjetet buxhetore përkatësisht të hyrat vetanake-kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është çmimorja e shërbimeve.

Neni 6

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës si dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

Neni 7

Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021.

Nr.Prot. 01-400/01-0078829/24
Podujevë, datë; 11 dhjetor 2024



Çmimet

e ofrimit të shërbimeve të varrimit nga Këshilli i Bashkësisë Islame - KBI, Podujevë

- 1. Transporti i kufomave** (bartja e kufomës nga shtëpia deri në Xhami dhe përcjellja deri në varreza; bartja nga Aeroporti në familje në rastet kur kufomat sjellën nga jashtë vendit; bartja e kufomës nga QKUK deri te familja në rastet kur ndërrojnë jetë në QKUK si dhe transport shtesë varësisht kërkesës së qytetarit/familjarit; transporti i nëpunësve të KBI dhe mjeteve të punës si dhe dezinfektimin i veturës/automjetit).....**60 €**
- 2. Fletë lajmërimi (afishe)**.....**20 €**
- 3. Dërrasat** (dërrasat me të cilat mbulohet kufoma pas lëshimit në varr, me dimensione; gjatësia 200 cm, gjatësia 115 cm dhe trashësia 05 cm).....**40 €**
- 4. Piramida** (Dërrasa me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit).....**20 €**
- 5. Vend pastrimi i kufomave** (banjë moderne për pastrimin e kufomave, mirëmbajtja e vend pastrimit dhe objektit përcjellës – rrymë, ujë detergjente e të tjera).....**20 €**
- 6. Pastrimi i kufomave** (pastrimi, mbështjellja dhe përgatitja e kufomës sipas rregullave Islame nga personi përgjegjës).....**55 €**
- 7. Mbulesa për mbështjelljen e kufomës**.....**10 €**
- 8. Qefini** (Pëlhura për mbështjelljen e kufomës ku përfshihen dorezat higjienike, pambuku dhe sapuni).....**25 €**

Totali i shpenzimeve.....**250 €**